

1. Kriteret e zbatuara nga ana juaj në përzgjedhjen e subjekteve që njoftohen zyrtarisht për t'u pajisur me autorizim për ushtrimin e veprimtarisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për përzgjedhjen e subjekteve që përdorin të drejtën e autorit për t'u njoftuar zyrtarisht nga Sporteli Unik, zakonisht ndiqen disa kriteret dhe procedura të përcaktuara në rregullore dhe aktet përkatëse ligjore për të drejtën e autorit si dhe metoda që kanë rezultuar efikase në eksperiencën 7 vjeçare të Sportelit Unik në mbledhjen e të ardhurave për të drejtën e autorit.

- a) **Identifikimi i Subjektit dhe aktiviteti ekonomik.** Si fillim bëhet indentifikimi i subjekteve. Subjektet duhet të jenë persona juridik ose fizik që përdorin vepra të mbrojtura nga e drejta e autorit në aktivitetin e tyre ekonomik ose publik.
- b) **Kategoria e veprave artistike** që përdoren duhet të jenë të llojit të muzikës, filmave etj sipas kategorive të licensimit nga Ministria e Kulturës e Agjencive të Administrimit Kolektiv. Mënyra e përdorimit të veprave të mbrojtura sipas kategorive që ka licensuar Ministria e Kultures duhet të jetë sipas përcaktimeve të Ligjit për të Drejtën e Autorit të ndryshuar Nr 35/2016 në Neni 130 dhe 131, 137 gërma a dhe 138.
- c) **Subjektet përzgjidhen duke u bazuar në llojin e aktivitetit të tyre ekonomik si dhe rëndësia që ka përdorimi i veprave të mbrojtura në aktivitetin e tyre.**

Prioritet u jepen platformave digjitale që transmetojnë apo shpërndajnë vepra të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe bizneseve që përdorin vepra artistike si muzikë dhe filma në shërbimet e tyre si televizionet, radiot, hotele.

- d) **Prioritizimi i sektorëve me ndikimi më të madh dhe lehtësia e identifikimit.** Në fazën e parë, përzgjedhja e subjekteve fokusohet në sektorët me përdorim më të lartë të veprave artistike të mbrojtura si Mediat audiovizuale (radio, televizione, kabllor). Këto subjekte gjithashtu janë më të lehtë të identifikueshëm pasi janë të regjistruar dhe licensuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizuale.

- e) **Subjekti Përdorues që njohin detyrimet ligjore.**

Subjektet përdorues që njohin detyrimet ligjore dhe janë të gatshëm për t'u pajisur me autorizimin për të drejtën e autorit trajtohen si subjekte jo problematike dhe përfshihen më shpejt në procesin e njoftimit dhe pajisjes. Sporteli Unik i trajton këto subjekte si partnerë për të patur ndikim edhe tek subjektet e tjera në grupet e tyre të interesit.

- f) **Grupet e interesit**

Sporteli Unik, përzgjedh fillimisht përdoruesit e veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit, bizneset të cilat janë të organizuar në formën e shoqatave për të realizuar një njoftim sa më efikas dhe të shpejtë të këtyre subjekteve, për detyrimet e tyre ligjore, duke realizuar takime informuese me përfaqësuesit e këtyre shoqatave apo grupeve të interesit.

g) Diversiteti

Një nga kriteteret të cilat Sporteli Unik mban parasysh, është diversiteti i subjekteve përdoruese të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit, të cilët kontaktohen prej nesh. Në këtë rast mbahet parasysh forma e organizimit duke përfshirë subjekte publike apo private, lloje të ndryshme të bizneseve, nga baret, restorantet, hotelet e deri te organizatorët e koncerteve dhe shfaqjeve dhe vendndodhja gjeografike, ku përveç kryeqytetit, edhe në të gjithë bashkitë e tjera të vendit, duke bërë një informim gjithëpërfshirës.

2. Mënyrat dhe procedurat që përdorni për gjurmimin dhe denoncimin e shkelësve të së drejtës së autorit, duke përfshirë mekanizmat e ndjekura për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Gjurmimi dhe denoncimi i shkelësve të së drejtës së autorit përfshin një sërë mënyrash dhe procedurash të cilat kombinojnë monitorimin, hetimin dhe zbatimin ligjor.

1. Monitorimi i aktiviteteve tregtare që përdorin vepra të mbrojtura.

a) Monitorimi fizik.

Monitorimi fizik konsiston në inspektimet në terren nga autoritetet përkatëse ligjore, ndaj bizneseve si restorante, hotele, klube nate, bar kafe, mjedise tregtare ku përdoren vepra artistike të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe kontroll i ngjarjeve publike si koncerte , festivale, evente për të verifikuar nëse veprat artistike përdoren me autorizim.

Institucioni që ka për detyrë të kryejë monitorimin fizik të përcaktuar në Ligjin për të Drejtat e Autorit është inspektoriat i shtetëror i mbikqyrjes së tregut. ISHMT kryen inspektimet në baze të denoncimeve nga SUADA si dhe kryesisht.

Inspektoriat i shtetëror përballet me sfidën e kryerjes së një numri të kufizuar inspektimesh, duke qenë se numri i subjekteve përdorues është shumë më i madh sesa kapacitetit inspektues. Kjo situatë krijon një hendek midis nevojës për mbikëqyrje efektive dhe burimeve të kufizuara të disponueshme. Duke qenë se nuk arrihet të kryhet monitorimi fizik një numër i madh subjektsh përdorues vazhdojnë të shkelin të drejtat e autorit duke përdorur vepra të mbrojtura pa autorizimin përkatës të SUADA.

Monitorim mund të kryhet edhe nga Autoriteti i Mediave Audiovizuale (AMA), por kjo ndodh kryesisht në kuadër të mbikëqyrjes së përmbushjes së detyrimeve ligjore. AMA është përgjegjëse për mbikëqyrjen e respektimit të ligjit mbi mediat audiovizuale.

Monitorimi i AMA mund të përfshijë:

Verifikimin e përdorimit të ligjshëm të veprave – AMA ju kërkon prova që OSHMA-të kanë autorizim të vlefshëm për përdorimin e materialeve të mbrojtura nga e drejta e autorit.

Sanksione – Nëse OSHMA-të nuk respektojnë detyrimet e tyre lidhur me të drejtat e autorit, AMA mund të vendosë penaltete administrative, siç parashikohet në ligjin për mediat audiovizuale.

Kjo ndodh në përputhje me ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizuale në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 35/2016 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" i ndryshuar. Nëse OSHMA përdor materiale të mbrojtura nga e drejta e autorit pa marrë leje ose pa paguar tarifat, AMA mund të marrë masa administrative.

b) Monitorimi dixhital.

Vëzhgimi i platformave online , faqeve të internetit , rrjeteve sociale dhe kanaleve të transmetimit për të identifikuar përdorimin e paautorizuar të veprave të mbrojtura artistike.

Për shkak të mungesës ligjore për platformat online dhe faqet e internetit, rrjetet sociale etj, si dhe kostos financiare për implementimin e softëare-ve të specializuar për të gjurmuar përmbajtjet e paligjshme, SUADA nuk e kryen monitormin dixhital.

Për gjurmimin dhe denoncimin e shkelësve të këtyre të drejtave, Sporteli Unik ndjek disa hapa dhe përdor mekanizma specifike. Këto janë proceset dhe metodat kryesore:

2. Mbledhja e të dhënave nga palët e interesuara

Raportime nga autorët dhe mbajtësit e të drejtave:

Autorët,interpretët, producentët dhe shoqatat kolektive mund të raportojnë raste shkeljesh pranë Sportelit Unik.

Denoncimi i shkelësve.

1. Njoftimi i subjekteve

Subjektet e dyshuara për shkelje njoftohen përmes shkresave zyrtare, postës elektronike dhe u kërkohet të pajisen me autorizimin përkatës ose të ndalojnë aktivitetin e paligjshëm.

2. Kallëzimi pranë institucioneve të tjera

Nëse subjekti nuk ndalon aktivitetin e paligjshëm, rasti kalohet:

- **ISHMT-së** për veprime administrative (gjopa, konfiskime, pezullime të aktiviteteve).
- **AMA – së** për veprime administrative ndaj subjekteve OSHMA bazuar ne ligjin per mediat audiovizuale.

Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të autorit.

a. Marrëveshja me Subjektet përdorues.

Promovohet zgjidhja paqësore, ku subjekti përdorues që ka kryer shkeljen i kërkohet të paguajë tarifat e kërkuara dhe të pajiset me autorizimin përkatës duke respektuar të drejtën e autorit.

b. Procedurat administrative.

Sporteli Unik njofton autoritetet përkatëse me shkresë zyrtare dhe postë elektronike ISHMT DHE AMA për të marrë vendime administrative në mënyrë që të ndëshkohen subjektet shkelëse

Masat e marra nga ISHMT dhe AMA janë shumë të vogla në numër në krahasim me numrin e madh të subjekteve përdorues që përdorin vepra të mbrojtura nga e drejta e autorit pa autorizim dhe në kundërshtim me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të drejtat e Lidhura me to.

c. Ngritja e padive civile ne Gjykatë dhe ndjekja penale për rastet e rënda.

Sporteli Unik mund të ngrejë padi civile ndaj Subjekteve përdorues për ti detyruar të ndërpresin shkeljen e të drejtave të autorit dhe për të detyruar që të përmbushë detyrimet specifike që vijnë si pasojë e përdorimit të veprave të mbrojtura sic janë pagesat për autorizimin.

Në rastet e rënda, Sporteli Unik mund të përgatis kallëzime penale dhe bashkëpunon me organet e drejtësisë si Policinë e Shtetit dhe Prokurorinë për të ndjekur rastet sipas Kodit Penal.

d. Sportelit Unik i mungojnë mekanizmat e drejtëpërdrejt si masat shtrënguese për të siguruar respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura.

SUADA ka një autoritet të kufizuar ligjor duke mos patur kompetenca të plota për të vepruar drejtëpërdrejt ndaj shkelësve dhe duke u varur nga institucionet e tjera si ISHMT, AMA, Gjykata.

3. *Analizën e detajuar mbi mosngritjen e rrjetit të zyrave të përfaqësimit nga SUADA, duke përcaktuar shkaqet dhe masat që parashikohen për adresimin e kësaj çështjeje.*

Sporteli Unik Per Administrimin e te Drejtes se Autorit (SUADA) zbaton Udhëzimin Nr 777 date 24.11.2023 të Ministrisë së Kultures “Per Menyren e funksionimit dhe Organizimit te Sportelit” si dhe Rregulloren e brendshme te vendosur nga Bordi Drejtues i

SUADA, Neni 6 pika 5 ku percaktohet : *Suada mban për kostot e veta të administrimit maksimumi 10% të të ardhurave mujore/vjetore të mbledhura.*

Për shkak të kësaj rregulloreje SUADA është e kufizuar në buxhetin e saj vjetor dhe kjo ka ndikuar në mosngritjen e rrjetit të zyrave të përfaqësimit nga Sporteli Unik për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura (SUADA).

Më poshtë është një analizë e detajuar e këtyre kufizimeve:

- 1. Buxhet i pamjaftueshëm.** Sporteli Unik nuk ka financim të mjaftueshëm që të mbulojë plotësimin e objektivave.
- 2. Mungesa e burimeve alternative të financimit.** Suada nuk ka mekanizma për të gjeneruar të ardhura shtesë përveçse të ardhurave nga tarifat për përdorimin e të drejtës së autorit. Mungojnë projekte të mbështetura nga donatorë të huaj si BE, UNESCO, Organizata ndërkombëtare që mbështesin mbrojtjen e të drejtave të autorit.
- 3. Kostoja e lartë për ngritjen dhe mirëmbajtjen e rrjetit të zyrave.**

Shpenzimet e infrastrukturës: Ngritja e zyrave të reja rajonale kërkon investime për hapësira, teknologji, dhe pajisje të nevojshme.

Shpenzimet operative: Pagat për personelin, trajnimi i tyre dhe kostot e tjera të përditshme operacionale shtojnë barrën financiare.

Moszbatimi masiv i të drejtës së autorit nga subjektet përdorues ndikon drejtëpërdrejtë në kufizimet financiare të Sportelit Unik për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura (SUADA), duke penguar aftësinë për tu zgjeruar.

Mungesa e pagimit të tarifave: Subjektet përdorues (si radio, televizione, bare, restorante, organizatorë eventesh, etj.) nuk respektojnë detyrimin për të paguar tarifat për përdorimin e veprave artistike muzikore dhe audiovizive.

Shmangia e pajisjes me autorizim: Përdorimi i paautorizuar i veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit rezulton në mungesë të fondeve që mund të ishin përdorur për funksionimin e SUADA-s.